

## NË EMER TË POPULLIT

P.nr:72/2017

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**—Departamenti për Krime të Rënda (në objektin e gjykatës në veri Mitrovicë), Kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët; Dragica Jakovljeviq dhe Branka Semenov, me procesmbajtësja Hasnije Muhaxheri, në çështjen penale kundër të pandehurës; [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale; Keqpërdorim i drejtës së votimit nga neni 216 par 1 të pika 1.2 të Kodi Penal i Republikës së Kosovës [KPRK-së], sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.393/2015, dt:16.05.2017. Gjykata, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë Ismet Ujkani, të pandehurës [REDAKTUAR] mbrojtësit të saj av.Dejan Vasiq. Seanca e shqyrtimit gjyqësor, ka qenë publike, është udhëhequr në mënyrë verbale, ku rrjedhja e shqyrtimit gjyqësor është regjistruar në procesverbal, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor më 30.04.2018, të njëjtën ditë me dt.30.04.2018, është shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa po të njëjtën ditë më 30.04.2018, është përpiluar me shkrim ky:

### AKTGJYKIM

#### Kundër të akuzuarës:

[REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] e lindur me dt. 19.09.1953 në Mitrovicë, me vendbanim në rr. [REDAKTUAR] në komuna [REDAKTUAR] me nr. personal: [REDAKTUAR] Serbe, shtetase e Republikës së Kosovës, punëtore, e martuar, e pensioniste, din të shkrim, lexim ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, ndaj saj nuk zhvillohet procedurë për vepra tjera penale.

*Gjykata në mbështetje të nenit 363 par.1 nenpar.1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP-ës) ndaj të pandehurës Zagorka Miliq;*

### REFUZOHET AKUZA

#### SEPSE:

Më 8 qershor 2014, në shkollën fillore "Vuk Kragjiq" – Zveqan në zgjidhjet nacionale për Kuvendin e Kosovës, në vendvotimin me [REDAKTUAR] ka votuar një herë si votues me kusht pastaj në shkollën fillore Vuk Kragjiq në Zveqan, të njëjtën ditë ka votuar edhe si votues e rregullt në vendvotimin nr: [REDAKTUAR]

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale; Keqpërdorim i drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të Kodi Penal i Republikës së Kosovës.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë buxhetore të kësaj gjykate.
- Kërkesë pasuroro-juridike nuk pati.

### A r s y e t i m

#### Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë—Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurës [REDAKTUAR] me dyshimin për veprën penale; Keqpërdorim i te drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-ës.

Më 22 maj 2017, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, aktakuzën PP.I.nr.393/2015, dt:16.05. 2017, kundër të pandehurës: [REDAKTUAR] ishte dorëzuar në këtë Gjykatë.



**Kompetenca e gjykatës:** Gjykata, pas pranimit të lëndës ka vërtetuar se në këtë çështje penale ka kompetencë lëndore dhe territoriale për ta shqyrtuar dhe për të vendosur në lidhje me këtë çështje. Gjykata, rikujton se kompetenca lëndore në këtë çështje penale rrjedhe nga fakti se vepra penale për të cilën është akuzuar e pandehura: [redacted] Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, përcaktohet se hyn në kompetencë lëndore në departamentin e krimeve të rënda, sipas Ligjit për gjykatat dhe nenit 22 Kodit Procedurës Penale të Kosovës. Ndërsa, kompetenca territoriale për këtë Gjykatë, rrjedhë nga fakti se vepra penale për të cilën ishte ngarkuar e pandehura: [redacted] dyshohet se është kryer në territorin e komunës së Zveqanit të cilin e mbulon Gjykata Themelore në Mitrovicë.

Gjykata, gjen se në lidhje me këtë çështje penale, kundër të pandehurës: [redacted] nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ishte ngritur kallëzimi penal i dt.30.03.2015.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, në këtë çështje penale ka mbajtur, gjithsejtë dy seanca të shqyrtimit gjyqësor. Seancat, janë mbajtur me dt.14.02.2018 dhe 30.04.2018. Seancat kanë qenë publike, janë regjistruar në procesverbal, janë mbajtur në prezencën e palëve; Prokurorit të Shtetit në PTH në Mitrovicë, Ismet Ujkani, të pandehurës [redacted] dhe mbrojtësit të saj av.Dejan Vasqi.

Më 30 prill 2018, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë Ismet Ujkani, ka hequr dorë nga ndjekja penale dhe nga aktakuza PP.I.nr.393/2015, dt:16.05.2017, ndaj të pandehurës; [redacted] për veprën penale: Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së. Me arsyetimin se, duke marr parasysh ekspertizën e grafologjisë, dhe mbrojtjen e të pandehurës, e bazuar në parimin in dubio pro reo, mëdyshjet në favor të pandehurit, nga këto arsye ka hequr dore nga ndjekja penale dhe akuzat për të pandehurën [redacted].


Gjykata, pasi ka pranuar vendimi e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - prokurori i rastit Ismet Ujkani për tërheqje nga akuzat PP.I.nr.393/2015, dt:16.05.2017, ndaj të pandehurës [redacted] vlerëson se, prokuroria ka të drejtë ligjore në çdo kohë të tërhiqet nga ndjekja penale, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, andaj nga këto arsye konsideron se në tërësi janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e akuzës dhe nxjerrjen e aktgjykimit refuzues në mbështetje me nenin 363 par.1 nën par 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e maur komfor neneve 454 par.1. të KPP-ës.

Nga të cekurat më lartë, e bazuar ne nenin 363 par 1. nën par 1.1 te KPP-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**P.nr.72/2017, i dt.30.04.2018**

**Procesmbajtësja:**  
**Hasnije Muhaxheri**



**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:**  
**Avni Mehmeti**



**KËSHILLË JURIDIKË:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi me shkrim, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

SAKTESIA E KOPJES E VERTETON  
TACINOST OTRAVNA POKRETOVJE

Punëtori i autorizuar  
Udhëheqës i radnik  
**SKolaja**